

TRANSKRIPT
Ndihmës Sekretari i Shtetit Dan Fried

Ndërtesa e Parlamentit – Përball Zyrës së Presidentit
Prishtine, Kosovë
17 Nëntor, 2008

Konferenca për shtyp është transmetuar drejtpërdrejt në RTK, Televizionin Publik të Kosovës – në ora 16:30

Pjesëmarrësit:

Presidenti Fatmir Sejdiu, Kryeministri Hashim Thaçi, Ndihmës Sekretari i Shtetit për Evropë, Dan Fried

DAN FRIED: zot. President, zot. Kryeministër. Ju faleminderit. Sot patëm biseda të mira. Diskutuam, ashtu si jemi marre vesh, për përkrahjen e përbashkët për shtrirjen e Eulex-it në tërë Kosovën. U pajtuam se duhet të gjendet mënyra se si të ecet para, duke pasur parasysh pozicionin e Qeverisë së Kosovës lidhur me gjashtë pikat, si dhe duhet pasur parasysh vullnetin e Kosovës që Eulex-i të vendoset sipas mandatit të vet të cekur në muajin Shkurt – gjithashtu duhet pasur parasysh vullnetin e Kosovës që të bashkëpunoj ngushtë me Bashkimin Evropian.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kane bashkëpunuar ngushtë me popullin e Kosovës me vite të tëra. Së bashku kemi kaluar nëpër situata të vështira. Shtetet e Bashkuara gjithnjë e kane mbajtur premtimin e dhënë popullit të Kosovës, dhe do ta bëjnë të njëjtën gjë edhe në të ardhmen. Më duhet të them, edhe pse unë nuk e përfaqësoj Qeverinë Evropiane, se edhe Evropa e ka mbajtur fjalën. Eulex-i është i gatshëm që të vendoset në Kosovë. Unë e di, e edhe Presidenti dhe Kryeministri me thane në mënyrë të qartë problemet që Qeveria e tyre i ka me këto gjashtë pika. Por, ne patëm një diskutim të mirë, patëm disa ide, i shkëmbyem ca prej tyre se si të ecet para, dhe unë do ti diskutoj këto ide me koleget e mi Evropian. Dhe, do ti bisedoj ato me Presidentin dhe Kryeministrin. Prandaj, ky ishte diskutim i mirë dhe produktiv. E ardhmja e Kosovës është në Evropë – shpresoj se Kosova një ditë do të jetë anëtare e Bashkimit Evropian. Prandaj, Kosova duhet ta gjej rrugën drejt Evropës. Besoj se edhe përkundër disa pyetjeve dhe shqetësimeve, madje edhe mospajtimeve për gjashtë pikat, se do të gjendet rruga se si të ecet përpara, gjë që do të mundëson vendosjen e Eulex-it, dhe shtrirjen e tij në tërë Kosovën. Prandaj, pata një bisedë të mirë gjatë ditës. Jam i kënaqur me bisedat tona – i kënaqur se do të gjejmë rrugën si të ecet përpara, dhe ky është qëllimi im.

Dëshiroj që t'iu them në fund, se unë nuk kam ardhur këtu vetëm. Kam ardhur i shoqëruar nga Gjenerali Paul Schaefer nga Qendra Komanduese Amerikane për Evropë, dhe ky fakt, duhet t'iu rikujtoj juve se SH.B.A.-të, përmes KFOR-it, kane historikun e mbajtjes së premtimeve, dhe fjalën tonë do ta mbajmë edhe në të ardhmen. Më kujtohet kur isha këtu në Korrikun e vitit 2007, dhe biseduam për vazhdimin e bisedimeve për statusin e Kosovës edhe për 120 ditët shtese të negociatave, dhe atëherë kishte mjaftë

dyshime, shumica e Kosovareve mendonin se: “ky është edhe një truk, dhe ne nuk do të fitojmë pavarësinë, ata do të na mashtrjnë, dhe nuk do ta mbajnë fjalën.” Por, SH.B.A.-të e mbajtën fjalën e dhënë, edhe Evropa e mbajti fjalën e vet dhe ne ecëm përpara. Prandaj, kërkesa ime për te gjitha ata të cilët brengosen është: Mos harroni se ne e kemi mbajtur fjalën në të kaluarën, dhe do ta mbajmë fjalën edhe në të ardhmen. Bashkëpunoni me ne, dhe ne do të vazhdojmë të ecim para. Më vjen mirë që jam kthyer në Republikën e Kosovës, i kënaqur që të bashkëpunoj me Presidentin dhe Kryeministrin drejt rrugës përpara.

PYETJET DHE PERGJIGJET

Pyetje: (*Arbër Vllahia, Korrespondent i BBC.*) Zotëri, Prishtina po e refuzon planin gjashtë pikësh-planin e KB. Beogradi qëndron i paluhatur pas pozicionit të vet. Ju thatë se keni pasur biseda shumë të mira me lidhshpimin Kosovar. Ku e shihni ju daljen nga kjo situatë? Cila është rrugëdalja për vendosjen e Eulex-it në Kosove, duke pasur parasysh pozicionet e Beogradit dhe Prishtinës?

Ndihmës Sekretari i Shtetit DAN FRIED: Po. Qeveria e Kosovës gjithnjë e ka mirëpritur vendosjen e EULEX-it, sipas vendimit të Bashkimit Evropian të muajit Shkurt. Tani, gjashtë pikat janë vendosur në bashkëpunim me Beogradin. Gjashtë pikat nuk janë diçka që do të jenë të përhershme. Është një marrëveshje kalimtare. E cila do të kalon. Ekzistojnë disa pjesë në kuadër të gjashtë pikave të cilat-më lejoni të them në mënyrë diplomatike – nxitin brenga. Ka pika tjera në kuadër të gjashtë pikave të cilat vërtetë do të jenë përmirësim i situatës momentale. Por, rruga përpara është vendosja e Eulex-it, dhe që Eulex-i të konsultohet me Qeverinë e Kosovës, në secilën fazë. Për arsye se në fund të fundit, po flasim për Kosovën, e cila është shtet. SH.B.A.-të e kanë njohur Kosovën, si dhe 52 shtete tjera në tërë botën e kanë njohur Kosovën, dhe është puna e diplomateve që ta gjejnë rrugën e cila shpie përpara, duke respektuar pozicionet e ndryshme, dhe mendoj se mund ta bëjmë këtë. Kjo është puna ynë.

Pyetje: (*emri i paqarte, korrespondent i Reuters-it*). A e përkrahin ende SH.B.A.-të vendosjen e Eulex-it me datën 2 Dhjetor, edhe nëse nuk arrihet marrëveshja për planin gjashtë pikësh?

Ndihmës Sekretari i Shtetit DAN FRIED: Ne e përkrahim vendosjen e Eulex-it sa më shpejtë që të jetë e mundur. Mendoj se data 2 Dhjetor është afati i cili është përmendur. Kalimi i kohës nuk e bënë këtë ma të mirë. Ne duhet të marrim disa vendime, që të ecim përpara shpejt. Eulex-i është i gatshëm, personeli i tij e dinë se çka duhet bërë, janë mjaft të aftë, prandaj duhet të gjejmë mënyrën e cila do të na mundëson të ecim përpara dhe ta bëjmë këtë.

Pyetje: zot. Fried, a pritni destabilizim të mëtutjeshëm në Kosovë, duke pasur parasysh eksplodimin e para disa ditëve i cili ndodhi pranë zyrës së ICO-s?

Ndihmës Sekretari i Shtetit DAN FRIED: Kjo ishte një ngjarje e tmerrshme. Kosova është shtet sovran dhe e pavarur, dhe çdo qytetar duhet ta dijë se e ardhmja e Kosovës

është në Evropë. Kosova nuk do të mund ta arrin një të ardhme të tillë nëse i jep hapësire personave radikal të cilët nuk janë miq të Kosovës, por të cilët në fakt, po e dëmtojnë kuzen e Kosovës.

Pyetje: (*Nebi Qena, Associated Press*) – A mendoni se ekziston marrëveshja se KB dhe Eulex-i do të pajtohen, ose Bashkimi Evropian do të merr përsipër sundimin e ligjit, nëse po, atëherë kur do të ndodhe kjo?

Ndihmës Sekretari i Shtetit DAN FRIED: Shpresojmë se do të ndodhe sa më shpejtë që është e mundur. Misioni i Eulex-it është misioni me ambicioz që Bashkimi Evropian e ka vendosur ndonjëherë – dhe me duhet të cekim së Shtete e Bashkuara të Amerikës janë pjesë e këtij misioni. Ne jemi të kyçur në kuadër të misionit. Ne kemi nënshkruar marrëveshjen me Bashkimin Evropian, dhe ne do të kontribuojmë në sektorin e policisë. Prandaj, ky nuk është vetëm mision Evropian, por edhe ne jemi pjesë e këtij misioni. Unë kam besim të madh në vendosmërinë e Bashkimit Evropian, dhe sa më parë që të vendosemi në terren, aq më mirë do të jetë – sa më parë që Misioni Evropian ta fillon mandatin e vet – aq më mirë do të jetë. Dhe në fund, nëse ne e kryejmë punën tonë mirë, pas dy viteve, askush nuk do ta mbanë mend këtë betejë për gjashtë pika, për arsye se Eulex-i do të jetë i vendosur në tërë Kosovën, dhe ne do të ecim përpara, do të vijmë njohjet e reja, dhe investimet. Kosova ka të ardhme të mirë. I kuptoj dyshimet. Ekziston shtypi i lire. Ekziston opozita, ata janë duke e bërë punën e tyre; por lidhshipi i Kosovës, jam i bindur se është i përkushtuar që të bashkëpunon me Bashkimin Evropian dhe Eulex-in.

Pyetje: (*Shkumbin Ahmetxhekaj, Radio Televizioni i Kosovës*). Çka ju premtuar sot udhëheqësve të Kosovës? Deri në ç'masë mund të ndryshohet plani gjashtë pikësh (pjesa tjetër e pyetjes nuk dëgjohet)?

Ndihmës Sekretari i Shtetit DAN FRIED: Sikur të mendoja se ky problem mund të zgjidhet me rihapjen e gjashtë pikave, ndoshta do të kisha dashur që të rihapen gjashtë pikat, por nuk mendoj se kemi të bëjmë me këtë. Mendoj se mënyra më e mirë për të ecur përpara është vendosja e Eulex-it. Se Eulex-i duhet të konsultohet me Qeverinë e Kosovës, e cila, sa i përket SH.B.A-ve, dhe 2/3 të shteteve të Bashkimit Evropian, është Qeveri sovraane e këtij shteti. Është me rëndësi që Eulex-i të shtrihet në tërë Kosovën – Kosova është shtet. Prandaj, le të vazhdojmë në bazë të kësaj. Kjo është pikëpamja e Qeveris sime.

Pyetje: (*Fatmir Aliu, Koha Ditore*) Ju lutem me përgjigjeni me po ose jo në pyetjen time – A e përkrahin Shtetet e Bashkuara të Amerikës planin gjashtë pikësh? Zonja Ambasadore ka thënë se ky plan është i mirë.

Ndihmës Sekretari i Shtetit DAN FRIED: Ambasadorja Kaidanow ka plotësisht të drejte. Planin gjashtë pikësh i ofron shumë Kosovës, por, duhet cekur faktin se Qeveria e Kosovës ka qëndrimin e vet për këtë plan. Qeveria e Kosovës është Qeveri sovraane, ata nuk ...ata i dëgjojnë përfaqësuesit e qeverive tjera, por vendimet i marrin vet, dhe është fakt se ne duhet të respektojmë vendimet e tyre. Kam lexuar mjaft akuza në shtypin dhe mediat Kosovare lidhur me atë se çka janë gjashtë pikat, dhe më duhet të them se disa

shkrime nuk janë të sakta, në fakt shumica prej tyre janë informata të gabueshme. Por ne do të bashkëpunojmë me Qeverinë e Kosovës. Është Qeveri sovrane, dhe mendojmë se gjashtë pikat, të cilat në fund të fundit, janë të përkohshme, kalimtare, jo të përhershme. Mendojmë se këto gjashtë pika kanë anët e veta pozitive dhe nuk bëjnë dem. Por, ne e respektojmë faktin se Qeveria e Kosovës ka pikëpamje tjetër. Prandaj, ne do të ecim përpara në bazë të miqësisë dhe përkrahjes për Qeverinë e Kosovës, por baza finale e marrëveshjes sonë është se Eulex-i duhet të vendoset në Kosovë. Dhe në bazë të kësaj marrëveshje, mendojmë se mund të gjejmë rrugën të ecim përpara, por ne do të vazhdojmë bisedat tona. Sidoqoftë, ju faleminderit shume.

Kryeministri Thaçi: Ju faleminderit.